

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. SULEJMAN KURTI

11/06/2019

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 04.11.2019 për subjektin e rivlerësimit, z. Sulejman Kurti, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 06.11.2019, vendosi: Shkarkimin nga deryra të subjektit të rivlerësimit, Sulejman Kurti, gjyqtar/kryetar i Gjykatës së Rrethit Elbasan.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupi gjykues i kryesuar nga znj. Firdes Shuli, z. Lulzim Hamitaj relator, znj. Valbona Sanxhaktari anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ndaj këtij vendimi, mund të ushtrohet ankimim pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.